



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

### DREJTORIJA E INSPEKTORATIT

<b>Datë :</b>	<b>05.09.2017</b>
<b>Referencë</b>	<b>11-344/8</b>
<b>Për :</b>	<b>Kryetar i Komunes- Imri Ahmeti</b>
<b>Përmes :</b>	<b>Drejtpërsëdrejti</b>
<b>Nga :</b>	<b>Drejtori i Drejtorisë të Inspektoratit - Imer Rrustemi</b>
<b>Lënda :</b>	<b>RAPORTI MUJOR-GUSHT</b>



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI KOMUNAL - LIPJAN  
DREJTORATI I INSPEKTORATIT



Pasqyra tabelare e punës për muajin – GUSHT

Inspektorët	Gjithsej	Inspektime me procesverbal	Pranime teknike	Fletëparaqitje për kundërvajtje	Inspektime për pirjen e duhanit	Vërejtje, njoftime	Mbyllje e përkohëshme	Lëndë e ekzekutuara gjyqësore	Inspektime të përbashkëta	Pëlqime sanitare	Vendosje e shiritav zyrtar	Inspektim i auto-taxi	Menaxhim i tregjeve	Aktivndime- ndalesa,urdhëresa	Kërkesa, pune me palë	Gjoha mandatore	Inspektim i kafshëve në thetore	Inspektime me polici	Inspektim i tokave bujqësore-korre shierjev	Biznese të paregjistruara dhe pa pranime teknike	Të hyra nga pranimet teknike	
Biznesit	242	15	7	3		21			22				4	64	64			6			14	
Ambientit	241	23				10			102					4	99			3				
Bujqësisë	592	7				65			23						258				239			
Ndërtimtarisë	56	18			2				18		1			2	15							
Trafikut	405	30		2		94	1		51			106	10		46			65				
Sanitar	74	8			15	4			29	1					3		14					
Gjithsejtë	<b>1610</b>	<b>101</b>	<b>7</b>	<b>5</b>	<b>17</b>	<b>194</b>	<b>1</b>	<b>245</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>106</b>	<b>14</b>	<b>70</b>	<b>505</b>		<b>14</b>	<b>76</b>	<b>239</b>	<b>14</b>			

Gjatë muajit Gusht kemi hasur në biznese të pa regjistruara në qendrën e regjistrimit të biznesit ku janë urdhëruar me procesverbal dhe me aktvendim që të bëjnë regjistrimin e tyre pranë qendresë së regjistrimit të bizneseve ARBK-së, Lipjan, gjithashtu kemi pasur biznese pa pëlqim nga inspektorët e tregut për të ushtruar aktivitetin biznesor, ku janë urdhëruar me procesverbal dhe aktvendim që të aplikojnë pranë Drejtoratit të Inspektoratit tek inspektorët e tregut, në bazë të kërkesave të bizneseve kemi bërë pranime teknike me procesverbal për plotësimin e kushteve tekniko minimale për të ushtruar veprimtarin e tyre biznese, po ashtu janë bërë fletëparaqitje për kundërvajtje ndaj bizneseve të cilët nuk i kanë respektuar urdhëresat e dhëna me procesverbal dhe të cilët kanë bërë mashtrime ndaj konsumatorëve gjatë blerjeve.

Janë bërë inspektime të subjekteve të ndryshme, afariste, të gjitha i kemi inspektuar në aspektin higjienik, për të gjitha vërejtjet i kemi dhënë urdhër me procesverbal për përmirësimin e kushteve. Kemi pasur një ankesë të një konsumatori rreth një produkti i cili nuk kishte plotësuar kushtet për konsum, produkti i tillë është asgjësuar kurse ndaj subjektit është bërë kërkesë për fillimin e procedurës për kundërvajtje (Fletëparaqitje).

Pas vaksinimit të kafshëve për sëmundjen gungore janë hapur të gjitha tregjet e kafshëve me vendim të AUV-it.

Janë inspektuar deponit ilegale të mbeturinave në disa fshatra, se po hasen qytetar duke hedhë mbeturina për të marrë masat ligjore ndaj tyre. Është bërë inspektim dhe është dhënë urdhëresë me procesverbal firmës që është duke kryer punimet në renovimin e Rr. Lipjan-Magurë për të rritur intensitetin e ujitjes së rrugës ende të paasfaltuar që mos të ngrihet pluhuri gjatë lëvizjeve së makinave. Është dalë në inspektim në disa fshatra si në Shalë, Krojmirë, Hallaq i Madh, Dobraj e Madhe, Gumnasell, Medvec etj, ankesat kishin të bëjnë me ujërat e zeza, mbeturinat, plehun e kafshëve etj, ku për secilin rast është konstatuar gjendja dhe janë marrë masat e duhura ligjore.

Janë inspektuar parqet e qytetit, ku disa shitësve u është dhënë urdhëresë për largimin e menjëhershëm dhe ndalim të shitjes së gjësendeve në parqe. Janë inspektuar dru rendet dhe është bërë një vlerësim mbi gjendjen e tyre dhe me këto informacione është njoftuar Drejtoria e Shërbimeve Publike.

Gjatë muajit Gusht kemi bërë inspektim në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari“ në Vrellë ku kemi organizuar aksion në bashkëpunim me Policin kufitare të Aeroportit në lidhje me disa auto-taksi të cilët po tentojnë të ushtrojnë veprimtari ilegale, pra për ata të cilët i kemi hasur duke ushtruar veprimtari ilegale janë marrë masat ndëshkimore në bazë të Ligjit. Po ashtu është bërë inspektimi në rrugën “Skënderbeu“ ku janë inspektuar auto-taksitë të cilët janë të vendosur në këtë rrugë.

Po ashtu gjatë këtij muajit në bashkëpunim me Policin e Kosovës njësi në Lipjan kemi bërë disa pika kontrolli në qytetin e Lipjanit ku janë inspektuar- kontrolluar edhe kompanitë e autobusëve të cilat operojnë në Komunën e Lipjanit në lidhje me rendin e udhëtimit se a janë duke e respektuar dhe është bërë kontrollimi për Licencë.

Gjatë muajit Gusht janë inspektuar objekte të shumta e të ndryshme ndërtimi dhe inspektuar lokacionet e vend ndërtimeve në terren, gjendja e ndërtimeve është nënë kontrollin e vazhdueshëm inspektues në zonat urbane dhe zonat jo urbane, objekte pa leje ndërtimi nuk janë identifikuar.

Gjatë këtij muaji janë inspektuar objekte ndërtimore rreth ndërrim destinimit të Tokës Bujqësore, janë inspektuar Tokat Bujqësore që po ju ndërrohet destinimi me mbushje dhe zhavorime të kompanive të ndryshme dhe janë ndërprerë tri punishte ku bëhej mbushja pasi që nuk posedonte ndërrim destinimin e tokës nga ajo Bujqësore në ndërtimore.

Janë inspektuar marketet ushqimore për produkte ushqimore me prejardhje bimore nga ana e Inspektorit të Bujqësisë.